

VENDIM
Nr. 772, datë 2.11.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ENERGJISË DHE INDUSTRIKË, NË CILËSINË E ORGANIT TË
INTERESUAR, PËR PAGESËN E FATURAVE TË AVOKATËVE TË KONTRAKTUAR
PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJET E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR ICC, NR. 20564/EMT HYDRO S.R.L. KUNDËR REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE ICSID, NR. ARB/15/28 HYDRO S.R.L. & OTHERS KUNDËR
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE ÇDO SHPENZIMI TJETËR TË LIDHUR ME
TO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e organit të interesuar, në buxhetin e miratuar për vitin 2016 i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 1 175 000.00 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) eurosh dhe 125 000.00 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarësh për kryerjen e pagesave të faturave të avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ICC, nr. 20564/EMT Hydro S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë dhe ICSID, nr. ARB/15/28 Hydro S.R.L. & Others kundër Republikës së Shqipërisë, si dhe për çdo shpenzim tjetër të lidhur me to, në përputhje me faturat e miratuara nga Avokatura e Shtetit.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi